ALEAT Sh.p.k

Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2012
(me raportin e auditorëve të pavarur)

ALEAT Sh.p.k

Përmbajtja

	Faqja
Raporti i Auditorit te Pavarur	i
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2012	1
Pasqyra e te ardhurave permbledhese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012	2
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012	3
Pasqyra e flukseve te parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012	5
Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012	6-35

KPMG Albania Sh.p.k
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i audituesve të pavarur

Pronarëve të
ALEAT Sh.p.k

Tiranë, 4 mars 2013

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të ALEAT Sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar në 31 dhjetor 2012, pasqyrat e të ardhurave përmbledhëse, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

KPMG Albania Sh.p.k., an Albanian limited liability company and a member firm of the KPMG network of independent member firms affiliated with KPMG International Cooperative ("KPMG International"), a Swiss entity.

Registered in the National Registration Center with VAT Number J91619001D

Opinioni

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2012, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Çeshtje e theksuar

Pa shtuar rezervë në opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen për Noten 2.d në pasqyrat financiare e cila sqaron se në përfundim te periudhës së konçensionit në 25 korrik 2013 dhe duke supozuar që nuk do ketë zgjatje të afatit të konçensionit, Shoqeria nuk do të ketë të drejte të vazhdoje veprimtarinë e konçensionit dhe do të duhet t'i dorëzoje veprimtarinë dhe infrastrukturën Shtetit. Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi gjykimin që marrëveshja e konçensionit nuk do të zgjatet.

KPMG Albania Shpk

KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

ALEAT Sh.p.k

Pasqyra e pozicionit financiar

(Shuma ne Lek, nese nuk eshte e specifikuar ndryshe)

	Shenime	31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2011
Aktive			
Aktivet e patrupezuara	6	427,574,456	1,141,748,428
Tatimi i shtyre	24	-	25,511,220
Total i aktive afatgjata		427,574,456	1,167,259,220
Inventare	7	419,752,825	345,806,918
Kerkesa per t'u arketuar	8	96,036,276	120,790,776
Parapagime dhe te tjera per t'u arketuar	9	18,878,023	18,288,139
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente	10	928,585,056	751,739,844
Total i aktiveve afatshkurtra		1,463,252,180	1,236,625,677
Total i aktiveve		**1,890,826,636**	**2,403,885,325**
Detyrimet afatgjata dhe kapitali aksioner			
Kapitali i nenshkruar	11	619,750,000	619,750,000
Fitimi i mbartur		513,460,621	1,103,416,403
Total i kapitalit aksioner		1,133,210,621	1,723,166,403
Provizione	12	67,299,720	47,299,720
Total i detyrimeve afagjata		67,299,720	47,299,720
Detyrime per t'u paguar	14	79,985,891	57,515,167
Te tjera detyrime	15	30,531,751	50,705,804
Tatim fitimi i pagueshem	24	3,591,745	12,003,328
Te ardhura te shtyra	16	165,079,658	195,952,234
Tarife konçesioni	17	411,127,250	258,319,029
Hua dhe kredi afatshkurter	13	-	58,923,640
Total i deyrime afatshkurtra		690,316,295	633,419,202
Total i detyrimeve dhe Kapitalit		**1,890,826,636**	**2,403,885,325**

Keto pasqyra financiare jane autorizuar per publikim nga drejtuesit e shoqerise ALEAT sh.p.k. me 4 Mars 2013 dhe u nenshkruan ne emer te tyre nga:

Jean-Alain JOUAN
Drejtori i pergjithshem ekzekutiv

Elton Toro
Drejtori i departamentit te finances

Shënimet në faqet 6 deri në 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALEAT Sh.p.k

Pasqyra e te ardhurave permbledhese per vitin e mbyllur me 31 dhjetor

(Shuma ne Lek, nese nuk eshte e specifikuar ndryshe)

	Shenime	2012	2011
Te ardhura nga shitja	18	3,097,311,208	5,191,984,232
Te ardhura te tjera	19	252,184	75,900,543
Fitimi bruto		3,097,563,392	5,267,884,775
Lende te para	20	(1,025,482,145)	(2,260,904,779)
Shpenzime koncesioni	17	(152,808,221)	(258,319,029)
Shpenzime personeli	21	(244,911,532)	(296,712,097)
Furnizime dhe sherbime	22	(411,994,551)	(464,528,645)
Amortizimi	6	(721,057,003)	(709,808,377)
Zhvleresimi i kerkesave te arketueshme	8	(402,990)	(6,969,179)
Provizione	12	(20,000,000)	(9,831,820)
Rezultati nga aktivitetet operative		520,906,950	1,260,810,848
Te ardhura financiare		38,811,100	33,927,753
Shpenzime financiare		(9,704,718)	(67,340,888)
Te ardhura/(shpenzime) financiare neto	23	29,106,382	(33,413,135)
Fitimi para tatimit mbi fitimin		550,013,332	1,227,397,714
Tatim mbi fitimin	24	(89,969,114)	(124,534,929)
Fitmimi per vitin		**460,044,218**	**1,102,862,785**
Te ardhura te tjera gjitheperfshirese		-	-
Totali i te ardhurave per vitin		**460,044,218**	**1,102,862,785**

Shënimet në faqet 6 deri në 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALEAT Sh.p.k

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital

(Shuma ne Lek, nese nuk eshte e specifikuar ndryshe)

	Kapitali aksioner	Fitim i mbartur	Total
Gjendja me 1 Janar 2011	**619,750,000**	**1,365,553,618**	**1,985,303,618**
Totali i te ardhurave gjithperfshirese per periudhen			
Fitimi neto i vitit	-	1,102,862,785	1,102,862,785
Te ardhura te tjera gjitheperfshirese	-	-	-
Totali i te ardhurave gjithperfshirese per periudhen	**-**	1,102,862,785	1,102,862,785
Veprime me aksionerët të rregjistruara direkt në kapital			
Kontribute nga aksionerët			
Dividend i paguar	-	(1,365,000,000)	(1,365,000,000)
Totali i veprimeve me aksionerët	**-**	**(1,365,000,000)**	**(1,365,000,000)**
Gjendja me 31 Dhjetor 2011	**619,750,000**	**1,103,416,403**	**1,723,166,403**

Shënimet në faqet 6 deri në 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALEAT Sh.p.k

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital (vazhdim)

(Shuma ne Lek, nese nuk eshte e specifikuar ndryshe)

	Kapitali aksioner	Fitime te mbartura	Total
Gjendja me 1 Janar 2012	**619,750,000**	**1,103,416,403**	**1,723,166,403**
Totali i te ardhurave gjithperfshirese per periudhen			
Fitimi neto i vitit	-	460,044,218	460,044,218
Te ardhura te tjera gjitheperfshirese	-	-	-
Totali i te ardhurave gjithperfshirese per periudhen	-	460,044,218	460,044,218
Veprime me aksionerët të rregjistruara direkt në kapital			
Kontribute nga aksionerët			
Dividend i paguar	-	(1,050,000,000)	(1,050,000,000)
Totali i veprimeve me aksionerët	**-**	**(1,050,000,000)**	**(1,050,000,000)**
Gjendja me 31 Dhjetor 2012	**619,750,000**	**513,460,621**	**1,133,210,621**

Shënimet në faqet 6 deri në 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALEAT Sh.p.k

Pasqyra e fluskeve te parase per vitin e mbyllur me 31 dhjetor

(Shuma ne Lek, nese nuk eshte e specifikuar ndryshe)

	Shenime	2012	2011
Flukset e parase nga veprimtarite operacionale			
Fitimi para tatim fitimit		460,044,218	1,102,862,785
Rregullime per:			
Amortizimi per aktivet te patrupezuara	6	721,057,003	709,808,377
Fitimi neto nga shitja e aktiveve jo-materiale	19	(252,184)	(703,117)
Tarife konçesioni e perllogaritur	27	152,808,221	258,319,029
Zhvlersimi i kerkesave per t'u arketuar	8	402,990	6,969,179
Provizione	12	20,000,000	9,831,820
Shpenzime per interesa-efekti i amortizimit te kostos se huave		-	3,406,031
Shpenzime per interesa		-	34,312,723
Te ardhura nga interesat		(23,778,192)	(16,757,521)
Tatim fitimi		89,969,114	124,534,929
Fitimi operativ para ndryshimit të kapitalit qarkullues:		**1,420,251,170**	**2,232,584,235**
Ndryshim ne aktivet dhe pasivet operative:			
Ndryshim ne inventare		(73,945,907)	114,378,214
Ndryshim ne kerkesa per t'u arketuar		24,351,510	137,838,037
Ndryshim ne parapagimet dhe te tjera per t'u arketuar		515,349	3,454,830
Ndryshim ne detyrimet per t'u paguar		22,470,724	(390,788,350)
Ndryshim ne detyrimet e tjera		(20,174,053)	(10,968,344)
Ndryshim ne te ardhurat e shtyra		(30,872,576)	(268,743,956)
Mjete monetare te gjeneruar nga aktiviteti operacional		**1,342,596,217**	**1,817,754,666**
Pagese e tarifes se koncesionit	17	-	(49,334,271)
Tatimi fitimi i paguar		(72,869,477)	(252,387,905)
Mjete monetare neto te gjeneruar nga aktiviteti operacional		**1,269,726,740**	**1,516,032,490**
Flukset e parase nga veprimtarite investuese			
Arketimet nga shitja e aktiveve	6	404,028	6,606,450
Blerje e aktiveve te patrupezuara	6	(7,034,875)	(35,317,947)
Interesi i arketuar		22,672,959	16,099,703
Mjete monetare perdorur ne veprimtarite investuese		**16,042,112**	**(12,611,794)**
Fluksi i parase nga veprimtarite financuese			
Dividenti i paguar	11	(1,050,000,000)	(1,365,000,000)
Pagesa per huate		(58,488,690)	(701,956,515)
Interesi i paguar		(434,950)	(39,717,190)
Mjete monetare e perdorur ne veprimtarite e financimit		**(1,108,923,640)**	**(2,106,673,705)**
Rritja/(pakesim) neto ne mjete monetare dhe te tjera equivalente te saj		176,845,212	(603,253,009)
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente me 1 Janar		751,739,844	1,354,992,853
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente me 31 Dhjetor (shenimi 10)		**928,585,056**	**751,739,844**

Shënimet në faqet 6 deri në 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

1. Te pergjithshme

a) Informacion i pergjithshem mbi Shoqerine

ALEAT sh.p.k. (“ALEAT “ose "Shoqeria”), eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar me Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR) me 18 gusht 2008 me NIPT K82018015V.

Aktiviteti i Shoqerise konsiston ne zbatimin e Marreveshjes se Sherbimit te Konçesionit (‘Marreveshja e Konçesionit’) nenshkruar me Qeverine Shqiptare (‘Autoriteti’) per prodhimin dhe shperndarjen e dokumentave te identifikimit dhe pasaportave elektronike dhe ne aktivitete te tjera te lidhura me zbatimin e marreveshjes se konçesionit si: rikonstruksion, sherbime te teknologjise se komunikimit dhe informacionit, themelimin dhe manaxhimin e nje rrjeti zyrash te ngritura per pranimin e aplikimeve per karta identiteti dhe pasaporta, perpunimin e te dhenave, printimin dhe shperndarjen e kartave te identitetit dhe pasaportave, etj. Marreveshja e Konçesionit hyri ne fuqi me 27 korrik 2008 (‘Data Efektive’) dhe pritet te perfundoje me 31 korrik 2013. Aksioneret e Shoqerise dhe pjesmarrjet e tyre respektive jabe si me poshte:

	Ne %	
Aksioneret	**31 Dhjetor 2012**	**31 Dhjetor 2011**
Morpho (me pare e njohur si Sageme Sécurité)	75.00	75.00
Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve (“FSHAN”)	25.00	25.00
	100.00	**100.00**

Shoqeria meme e Shoqerise eshte SAFRAN Group. Sipas kushteve te Marreveshjes se Konçesionit, FSHAN dhe Morpho do te jene aksioneret e vetem te Shoqerise pergjate periudhes se konçesionit dhe ne rast transferimi te aksioneve ndermjet njeri-tjetrit, Morpho do te zoteroje te pakten 50.1% te aksioneve me te drejte vote. Shoqeria ka adresen e saj te regjistruar ne rrugen “Qemal Stafa” (ish Tipografia Ushtarake) dhe ka 273 punonjes me 31 dhjetor 2012 (2011: 316 punonjes). Drejtori i pergjithshem ekzekutiv i Shoqerise eshte Z. Jean-Alain Jouan i emeruar dhe i regjistruar bazuar ne vendimin e QKR nr. 21671/1, date 21 tetor 2008.

b) Marreveshja e Konçesionit – kushte te rendesishme

Pershkrimi

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9663, date 18 dhjetor 2006 “Mbi konçesionet” dhe Ligjin Nr. 8952, date 10 tetor 2002 “Mbi pajisjen me pasaporta te qytetareve shqiptare” ashtu si dhe Vendimet e Keshillit te Ministrave Nr. 541, date 26 korrik 2006; Nr. 27, date 19 janar 2007; Nr. 253, date 27 prill 2007; Nr. 715, date 6 nentor 2007; Nr. 196, date 13 prill 2007 dhe Nr. 525, date 8 gusht 2007 ne lidhje me pajisjen me mjete identifikimi dhe pasaporta te qytetareve shqiptare, Qeveria shqiptare perfaqesuar nga Ministria e Brendshme (‘Autoriteti’) lidhen nje Marreveshje Konçesioni me Shoqerine (Konçesionari) me 27 Korrik 2008.

Ne perputhje me kushtet e caktuara ne Marreveshje, Ministria e Brendshme financon dhe autorizon Konçesionarin per te ofruar sherbimet e dizenjimit, themelimit, zhvillimit, implementimit dhe operimit te sistemit per ofrimin e kartave te identitetit dhe pasaportave qytetareve dhe ose rezidenteve te tjere ne Shqiperi.

1. Te pergjithshme (vazhdim)

b) Marreveshja e Konçesionit – kushte te rendesishme (vazhdim)

Nje Amendim i Marreveshjes se Konçesionit ("Amendimi") u nenshkrua me Autoritetin me 13 korrik 2010, u aprovua nga Parlamenti Shqiptar me 23 shtator 2010 dhe eshte efektiv duke filluar nga data 5 nentor 2010. Ne baze te Amendimit, Autoriteti pranoi te paguaje per sherbimet e reja ("Sherbimet e reja") dhe te kompensoje per sherbimet shtese te kryera ne 2009 pertej objektit te Marreveshjes origjinale ("Sherbimet e Kryera"). Ne perputhje me Marreveshjen, Shoqeria do te realizoje sherbimet e saj sipas menyres se meposhtme:

a) Do te instaloje infrastrukturen dhe sistemet per pergatitjen e kartave te identitetit dhe pasaportave te cilat perfshijne sistemet e Aplikimit dhe Regjistrimit; Manaxhimit te te dhenave biometrike; Kontrollit te Cilesise; Transportit dhe Leshimit; Personalizimit; dhe sistemin e Infrastruktures se Autoritetit te Çertifikimit.
b) Ngritjen e nje Ambjenti Qendror per Personalizimin ne nje zone te ofruar nga Autoriteti nepermjet rikonstruksionit fizik, rregullimeve te kushteve te sigurise si dhe perdorimit te teknologjise ashtu siç eshte rene dakord ne kushtet e Marreveshjes dhe Amendimit.
c) Ngritja e nje rrjeti te zyrave te Aplikimit ne zona te vena ne dispozicion nga Autoriteti me personel te kualifikuar si dhe me pajisje te pershtatshme aplikimi dhe regjistrimi per dokumentat e identifikimit ne perputhje me kushtet e Marreveshjes dhe Amendimit.
d) Ngritja e nje ndertese per ruajtjen e te dhenave e cila te sherbeje si nje arkive e sigurt per te gjitha te dhenat.
e) Dizenjimi, implementimi, dhe operimi me nje sistem te plote dhe te integruar software i cili do te mbeshtese te gjitha proçeset e siperpermendura si ne nivel lokal (ne zyrat e aplikimeve) ashtu dhe ne nivel qendror (Ambjenti Qendror per Personalizimin).

Ne perputhje me Amendimin, Shoqeria do te ofroje edhe "Sherbimet e reja" si me poshte:

- Dizenjimin, ngritjen, zhvillimin, implementimin dhe operimin e Sistemit per rritjen e kapacitetit te - prodhimit dhe shperndarjes se pasaportave ne perputhje me specifikimet e Amendimit.
- Dizenjimin, ngritjen, zhvillimin, implementimin dhe operimin e Sistemit per pajisjen me Dokumenta Identifikimi te Emigranteve ne perputhje me specifikimet e Amendimit.
- Ngritja e nje rrjeti te Zyrave te Aplikimit ne zyrat konsullore/ambasadat e Republikes se Shqiperise ne vendet e huaja ne perputhje me specifikimet e Amendimit.
- Dizenjimin, ngritjen, zhvillimin, implementimin dhe operimin e Sistemit per pajisjen me Pasaporta me Procedure te Pershpejtuar ne perputhje me specifikimet e Amendimit.

Detyrime te tjera te rendesishme te Shoqerise perfshijne:

- Garantimin e shperndarjes se kartave te identitetit dhe pasaportave brenda afateve te caktuara ne Marreveshjen e Konçesionit, ne te cilen parashikohen penalitete ne rast te vonesave te shperndarjes se tyre bazuar ne te dhenat mesatare vjetore.
- Garantimin e nje cilesie te larte dhe besueshmerie te larte pergjate periudhes se konçesionit.
- Garantimin e konfidencialitetit, sigurise dhe integritetit te te dhenave biometrike te mbledhura per qytetaret shqiptare.

1. Te pergjithshme (vazhdim)

b) Marreveshja e Konçesionit – kushte te rendesishme (vazhdim)

Te drejta te tjera te Shoqerise perfshijne:

- Ushtrimin e te gjitha te drejtave, ne lidhje me zoterimin dhe perdorimin pa pagese te ambjenteve te siguruara nga Autoriteti me qellimin e realizimit te objektivave (b) deri ne (d).
- Negocimi dhe zgjatja e periudhes se konçesionit ne perputhje me kushtet e Marreveshjes.

Detyrimet kryesore te Autoritetit perveç sigurimit te ambjenteve pershkruar me lart perfshijne gjithashtu:

- Marrjen e te gjitha masave te nevojshme per ta bere te detyrueshme pajisjen me karta identiteti per qytetaret shqiptar mbi moshen 16 vjeç.
- Pergjegjesine per venien ne dispozicion te Shoqerise te informacioneve dhe te dhenave te nevojshme per te realizuar objektivat e caktuara ne Marreveshje.

Kushte te rendesishme qe mund te prekin shumen, kohezgjatjen, dhe sigurine e flukseve monetare:

- Periudha e konçesionit: Konçesioni zgjat per nje periudhe minimale prej 5 vitesh duke filluar nga Data Efektive.
- Periudha e Konçesionit mund te zgjatet nese numri i kartave te identitetit dhe pasaportave te shitura nuk arrin numrin minimal te caktuar deri ne fund te kohezgjatjes se Marreveshjes dhe nese kjo nuk vjen si pasoje e veprimeve te Konçesionarit.
- Te drejtat e konçesionit duhet te jene eskluzive dhe Konçesionari duhet te kete te drejta eksluzive dhe te vetme te shitjes se kartave te identitetit dhe pasaportave pergjate periudhes se konçesionit.
- Çmimi per kartat e identitetit dhe pasaportat, kartat e identitetit per emigrantet, kartat e identitetit qe leshohen nga zyrat e aplikimit ne Ambasade, si dhe dokumentet e sherbimit me procedure te pershpejtuar, eshte i percaktuar ne Marreveshjen me Autoritetin dhe duhet te qendroje fiks pergjate periudhes se konçesionit. Çmimi i parapaguhet Shoqerise.

Dorezimi i konçesionit

Pas perfundimit te Marreveshjes se Konçesionit, Konçesionari duhet te beje dorezimin e ambjenteve te Konçesionit tek Autoriteti. Shoqeria duhet te transferoje tek Autoriteti çdo te drejte apo titull ne lidhje me ambjentet e Konçesionit dhe te gjithe aktivet e dezinjuara dhe te perdorura gjate periudhes se konçesionit. Githashtu, Konçesionari duhet t'i dorezoje Autoritetit, pa asnje tarife apo pagese te metejshme, te gjitha dokumentat dhe te dhenat ne zoterim te tij qe kane lidhje me konçesionin.

Konçesionari duhet te siguroje qe te gjitha aktivet, te drejtat, pronat dhe zerat e tjere referuar ne kete pike te Marreveshjes te cilat do t'i transferohen Autoritetit duhet te jene ne kushte te mira pune dhe te riparuara mire ne menyre qe sistemi te kete mundesi te funksionoje normalisht, per tre vite te tjera pa lindur nevoja per te zevendesuar ndonje pjese, me perjashtim te materialeve te konsumit, dhe pa perdorur asnje detyrim garancie pertej periudhes nje vjecare pas Periudhes se Konçesionit.

Zgjidhja e Marreveshjes

Autoriteti ka te drejte te zgjidhe ne menyre te njeanshme Marreveshjen e Konçesionit nese Shoqeria nuk permbush detyrimet e saj sipas Marreveshjes dhe nese kjo mangesi vazhdon edhe 60 dite pas njoftimit me shkrim per kete shkelje; nese Shoqeria ka probleme me likuiditetin apo nese ka transferim te aksioneve jo ne perputhje me kushtet e Marreveshjes. Nga ana tjeter, Shoqeria ka te drejte te zgjidhe Marreveshjen e Konçesionit nese Autoriteti kryen shkelje te rende te detyrimeve te tij sipas Marreveshjes per nje periudhe me te gjate se 60 dite.

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarate e perputhshemire

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e kostos historike. Parimi i vijueshmërise në përgatitjen e pasqyrave financiare nuk është përdorur pasi siç shpjegohet edhe në noten 2.d aktiviteti i Shoqërisë do të përfundoje gjatë 12 muajve të ardhshëm. Rrjedhimisht, pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me politikat kontabël të aplikura më poshtë.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare jane paraqitur ne Lek shqiptar ('Lek') e cila eshte monedha funksionale dhe raportuese e Shoqerise. I gjithe informacioni financiare eshte paraqitur ne Lek shqiptqar nese nuk eshte specifikuar ndryshe.

(d) Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Në vecanti, elemente të rëndësishme të pasigurive në vlerësim dhe gjykimeve kritike në zbatimin e politikave kontabël, të cilat kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshirë në paragrafet e mëposhtme:

(i) Dorezimi i konçesionit në Korrik 2013

Siç shpjegohet edhe në notën 1 (b) të këtyre pasqyrave financiare, në përputhje me afatet dhe kushtet të vendosura në Marrëveshjen e Konçesionit, me të përfunduar periudha e konçesionit, në 25 korrik 2013, Shoqëria nuk do jetë më në gjendje të vazhdoje konçensionin dhe do duhet të dorëzoj të gjitha të ambjentet e Konçensionit tek Autoriteti.

Pavarësisht fakteve të sipërmendura, vlerësimet e mësipërme mund të ndryshojnë, nëse të dhena për një zgjatje të mundshme te periudhës së konçesionit ekzistojnë. Neni 3.3.1 i Marrëveshjes së Konçensionit siguron një mekanizëm për zgjatjen e periudhës së konçesionit, në bazë të të cilit Autoriteti dhe Shoqëria, pas një periudhe dy vjeçare nga Data Efektive, mund te diskutojne rreth afateve dhe kushteve për zgjatjen Marrëveshjes së Konçensionit.

Duke filluar nga data 6 dhjetor 2012, Shoqëria dhe Autoriteti kanë filluar diskutimet rreth zgjatjes së mundshme të Marrëveshjes së Konçensionit. Deri në daten e raportimit këto diskutime jane duke vazhduar dhe afatet e kushtet kryesore për zgjatjen e Marrëveshjese se Konçensionit nuk janë ende përcaktuar dhe rënë dakort.

Si pasoje pasqyrat financiare janë përgatitur mbi vlerësimin se Shoqëria nuk do jetë në gjendje të vazhdojë aktivitetin e saj për 12 muajt e ardhshëm dhe do e dorëzoje konçensionin më 25 korrik 2013 sipas përcaktimeve në Marrëveshjen e Konçensionit.

Megjithëse drejtimi i Shoqërisë shpreh besim të plote në mundësine dhe proçesin e zgjatjes së afatit të Kontratës së Konçensionit, ka vendosur të përgatisë këto pasqyra financiare duke u bazuar ne gjykimet e mësipërme, vetëm për qëllime te kujdesit paraprak duke marrë parasysh kushtet dhe rrethanat deri në momentin aprovimit të këtyre pasqyrave financiare.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

(d) Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

(ii) Tatimet mbi fitimin

Shoqeria eshte subjekt i tatimit mbi te ardhurat ne Shqiperi. Nje gjykim i rendesishem kerkohet ne lidhje me percaktimin e shumes se tatim-fitimit. Ekzistojne transaksione per te cilat trajtimi tatimor perfunditmar eshte i paqarte. Shoqeria i njeh detyrimet per inspektime tatimore te pritshme bazuar ne vleresimin e detyrimeve per tatime shtese. Aty ku rezultati final tatimor i ketyre çeshtjeve eshte i ndryshem nga shumat e njohura fillimisht, diferencat do te ndikojne ne aktivet dhe detyrimet per tatim-fitimin aktual dhe dhe ate te shtyre per periudhen ne te cilen eshte bere nje percaktim i tille.

(iii) Amortizimi i aktiveve jo-materiale

Amortizimi i aktiveve jo-materiale llogaritet me metoden lineare bazuar ne kohezgjatjen e Marreveshjes se Konçesionit. Çdo shtese ne kohezgjatjen e Marreveshjes se Konçesionit do te reflektohet ne metoden e amortizimit te aktiveve jo-materiale ne momentin kur do te kete siguri te plote ne lidhje keto shtesa.

(iv) Provizionet

Provizionet për shërbimet e mirëmbajtjes që shoqeria duhet ti japë Autoriteteve pas dates se përfundimit pa kompensim shtesë është i bazuar në vlerësimin e bërë nga të dhënat historike të lidhura me shërbime të mirëmbajtjeve të ngjashme.

Provizionet per shpërblimin mbi vjetërsinë në punë, që Shoqëria i detyrohet punonjësve te saj në fund të periudhës së konçensionit, është vlerësuar duke u bazuar në vjetërsinë në punë që kane punonjësit e Shoqërise deri në datën e raportimit dhe përcaktimeve të Kodit të Punëse së Republikës së Shqipërisë.

3. Permbledhje e politikave kontabël

Politikat e mëposhtme kontabël jane aplikuar ne vazhdimesi tek te gjitha periudhat e paraqitura ne pasqyrat financiare.

(a) Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhe funksionale duke perdorur kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në valutë të huaj në datën e raportimit rivlerësohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Fitimi ose humbja neto e valutës ne mjetet monetare është diferenca midis kostos së amortizuar të monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos se amortizuar në monedhë të huaj e konvertuar me kursin e këmbimit të fund të periudhës. Diferencat në monedhë të huaj që vijnë nga rikonvertimi njihen si fitim ose humbje, mjetet jo-monetare në monedhë të huaj që maten në termat e kostos historike konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

(b) Instumenta financiar

Instrumentat financiare jo-derivative te Shoqerise perfshijne llogari e te tjera te arketueshme, mjete monetare dhe ekuivalente te tyre, hua te marra e te dhena dhe llogari e te tjera te pagueshme. Gjatë periudhave raportuese nuk ka investime në kapital dhe letrat me vlerë të borxhit Shoqeria i klasifikon aktivet e saj financiare vetem ne kategorite e huave dhe te arketueshmeve.

Instrumentat financiare jo-derivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus kostot e transaksioneve qe lidhen me to, per instrumentat jo me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes, perveç siç pershkruhet me poshte. Ne vijim te njohjes fillestare, instrumentat financiare jo-derivative maten si me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te shoqerise mbi flukset e parase se aktivit financiar ose kur shoqeria transferon aktivin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithe risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anullohen.

Njohja e te ardhurave dhe kostove financiare diskutohen ne shenimin 3(j) dhe (k).

Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente

Mjetet monetare dhe te tjera ekuivalente perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat dhe investime te tjera likuide me maturim jo me te gjate se 3 muaj.

Kerkesa per t'u arketuar

Kerkesat per t'u arketuar njihen fillimisht me vlere te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjet nga zhvleresimi.

3. Permbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(c) Instrumenta financiare

Koncesioni – Modeli i aktiveve financiare

Sipas Amendimit te Marreveshjes se Konçesionit Shoqeria do te rimbursohet nga Autoriteti per sherbimet e meposhtme:

- Dizenjimin, ngritjen, zhvillimin, implementimin dhe operimin e Sistemit per rritjen e kapacitetit te prodhimit dhe shperndarjes se pasaportave ne perputhje me specifikimet e Amendimit.
- Dizenjimin, ngritjen, zhvillimin, implementimin dhe operimin e Sistemit per pajisjen me

Kompensimi i dhene nga Autoriteti ne lidhje me sherbimet e lartpermendura sjell lindjen e nje aktivi financiar ne baze te KINRF 12, i cili njihet fillimisht me vleren e drejte te shumes se arketuar per sherbimet e ofruara / qe do te ofrohen.

Ky aktiv financiar kompensohet me pas me detyrimin financiar ndaj Autoritetit meqenese Shoqeria ka te drejten ligjore per te kompensuar shumen e arketueshme nga Autoriteti, sic parashikohet ne Amendimin e Marreveshjes se Konçesionit, me tarifen e pagueshme te konçesionit ndaj Autoritetit.

Detyrime per t'u pagur

Detyrime per t'u paguar jane paraqitur ne vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e amortizuar.

Hua dhe kredi

Huate e marra dhe te dhena njihen fillimisht me vleren e drejte. Pas njohjes fillestare, huate e marra dhe te dhena paraqiten me kosto te amortizuar duke njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve çdo diference midis kostos dhe vleres se pagueshme nominale pergjate periudhes se huamarrjes duke u bazuar ne metoden e interesit efektiv.

Tarifat e pagueshme ndaj Autoritetit

Tarifat e pagueshme ndaj Autoritetit regjistrohen si detyrim financiar kur sherbimet i ofrohen perdoruesve.

Aktivet dhe detyrimet financiare janë kompensuar dhe shuma neto paraqitet në pasqyren e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur, Shoqeria ka një të drejtë ligjore për të kompensuar shumat dhe ka për qëllim ose për të vendosur mbi një bazë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrim në të njëjtën kohë.

Te tjera

Instrumenta te tjere financiare jo-derivative maten me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv minus humbjet nga zhvleresimi.

Instrumentat financiare klasifikohen si detyrime afatshkurtra me perjashtim te rastit kur Shoqeria ka nje te drejte te pakushtezuar te shtyje shlyerjen e detyrimit per te pakten 12 muaj pas dates se raportimit.

(d) Kapitali aksioner

Kapitali aksionar i Shoqerise njihet me vleren nominale.

3. Permbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(e) Aktive jo-materiale

(i) Modeli i aktiveve jo-materiale

Sipas Marreveshjes se Konçesionit, Shoqeria duhet te pajise me karta identiteti dhe pasaporta te gjithe shtetasit shqiptare. Autoriteti kontrollon dhe rregullon sherbimet qe Shoqeria ofron, ndaj kujt i ofron dhe me çfare çmimi. Autoriteti gjithashtu kontrollon çdo interes te rendesishem ne infrastrukturen e dhene Shoqerise ose te blera nga kjo e fundit per qellime te ofrimit te sherbimeve sipas Marreveshjes se Konçesionit. Meqenese Marreveshja e Konçesionit ploteson perkufizimin e marreveshjes se konçesionit sipas KINRF 12 , Shoqeria ka aplikuar kerkesat e KINRF 12 mbi kete transaksion.

Shoqeria ka zbatuar modelin e aktiveve jo-materiale sipas KINRF 12. Ne lidhje me te drejten e saj per te ngarkuar perdoruesit e sherbimeve publike te meposhtme:

- Pajisjen me karta identiteti dhe pasaporta ne Republiken e Shqiperise sipas Marreveshjes se Konçesionit,
- Pajisjen me Dokumenta Identifikimi ne Zyrat e Aplikimit ne zyrat konsullore/ambasadat e Republikes se Shqiperise ne vendet e huaja sipas Amendimit,
- Ofrimin e Sherbimeve me Procedure te Pershpejtuar sipas Amendimit.

Shoqeria njeh nje aktiv jo-material ne masen e te drejtes se fituar per ngarkimin e perdoruesve te sherbimit publik. Te gjitha aktivet e perdorura nga Shoqeria njihen ne fillim si aktive jo materiale me vleren e drejte te pageses ose detyrimit te pagueshem per to dhe vleren e drejte te aktiveve jo monetare te dhena ne shkembim per konçesionin. Ne vijim te njohjes fillestare, instrumentat financiare jo-materiale maten si kosto, cka perfshine kostot e huas se kapitalit minus kostot e akumuluara te amortizimit dhe humbjeve nga zhvleresimet.

(ii) Makineri dhe pajisje te blera, rinovimet dhe te tjera shpenzime

Aktivet jo-materiale perfshijne vleren e paguar per pajisjet e blera dhe per rinovimet e aktiveve te dhena nga Autoriteti. Shpenzimet e tjera ne lidhje me aktivet jo-materiale qe rezultojne nga Marreveshja e Konçesionit njihen ne shumen e mbartur te aktiveve jo-materiale.

(iii) Kostot e huamarrjes

Kostot e huamarrjes ne lidhje me aktive te kualifikuara kapitalizohen si pjese e kostos se aktivit.

3. Permbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(e) Aktive jo-materiale

(iv) Amortizimi

Aktivet jo-materiale kane nje jete te dobishme te percaktuar e cila perfundon ne fund te Marreveshjes se Konçesionit qe eshte data 31 korrik 2013 dhe njihen me vleren historike duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe zhvleresimin e akumuluar. Shoqeria amortizon aktivet jo-materiale duke perdorur metoden lineare mbi jeten e dobishme te aktivit te patrupezuar duke filluar qe nga data kur aktivi eshte i gatshem per perdorim. Jetet e dobishme te perllogaritura per periudhen aktuale jane si me poshte::

Permiresime ne qiramarrje	*Me e shkurtera mes kohezgjatjes se qirase dhe periudhes se konçesionit*
Shpenzime rinovimi	*Periudha e konçesionit*
Makineri dhe Pajisje	*Periudha e konçesionit*
Software	*Periudha e konçesionit*
Pajisje IT dhe aktive te tjera	*Periudha e konçesionit*

Metoda e amortizimit dhe jeta e dobishme e aktiveve rishikohen dhe rivleresohen ne fund te çdo periudhe raportimi.

(f) Inventaret

Inventaret paraqiten me nje vlere te barabarte me me te ulten midis kostos dhe vleres neto te realizueshme. Kosto percaktohet me metoden mesatare dhe perfshin materiale te para, punen direkte, kosto te tjera direkte dhe shpenzime te tjera te lidhura. Vlera neto e realizueshme eshte cmimi fiks i shitjes siç eshte percaktuar ne Marreveshjen e Konçesionit duke i zbritur shpenzimet variabel te shitjes.

(g) Zhvleresimet

(i) Aktive financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet i zhvleresuar nese ka te dhena objektive qe tregojne se nje apo disa ngjarje kane efekte negative ne flukset e ardhshme monetare qe parashikohet te gjenerohen nga aktivi. Humbja nga zhvleresimi i nje aktivi financiar te matur me kosto te amortizuar llogaritet si diference midis vleres kontabel neto te aktivit dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktive financiare te rendesishme testohen per zhvleresim individualisht. Aktivet e tjera financiare vleresohen kolektivisht, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te rrezikut kreditor. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me nje aktiv financiar i disponueshem per shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet ne shpenzime. Nje humbje nga zhvleresimi rimerret nese rimarrja mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pas njohjes se humbjes nga zhvleresimi. Per aktivet financiare te matura me kosto te amortizuar rimarrja njihet ne fitime ose humbje.

(ii) Aktive jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përvec inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në cdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.Humbjet nga zhvlerësimi ne periudhat e mëparshme janë rishikuar ne cdo date raportimi për rastet kur humbja rritet ose nuk ekziston me. Një humbje zhvlerësimi anullohet nëse ka patur ndryshim ne vlerësimet e përdorura për caktimin e vlerës se rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anullohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

3. Permbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(h) Perfitimet e punonjësve

Pensionet e detyrueshme

Shoqeria, në rrjedhën normale të biznesit të saj, bën pagesat në emër të vet dhe në emër te punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet e detyrueshme sipas legjislacionit lokal. Shpenzimet e bëra në emër të kompanisë regjistrohen si fitim dhe humbje kur ndodhin.

Leje vjetore

Shoqeria e njeh si detyrim shumën e pa-zbritur të kostos së parashkuar per leje vjetor që pritet për t'u paguar në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e caktuar.

(i) Provizionet

Provizionet per restaurimin e infrastruktures, kostot e rikonstruksionit, si dhe ankimime ligjore njihen kur Shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv si rezultat i ngjarjeve te meparshme, ne rast se ekziston mundesia e flukseve dalese te burimeve ekonomike per te mbyllur detyrimet dhe nese vlera e detyrimit te mund te percaktohet me vertetesi. Provizionet nuk njihen per humbjet e ardhshme operative. Kur ka nje numer detyrimesh te ngjashme, mundesia e daljes se burimeve ekonomike per shlyerje te tyre, përcaktohet duke konsideruar kategorine e detyrimeve si nje te vetme. Provizionet maten me vleren aktuale te shpenzimeve te pritshme per te shlyer detyrimin duke perdorur nje norme skontimi para tatimit e cila pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet qe lidhen me detyrimin ne fjale. Rritja ne provizione si pasoje e kalimit te kohes njihet si kosto financiare.

Sherbimet e mirëmbajtjes (ose Detyrimet pas Dorezimit)

Sherbimet e mirembajtjes se makinerive dhe pajisjeve te siguruara pa pagese pas Periudhes se Konçesionit njihen si nje detyrim financiar me nje aktiv te patrupezuar respektiv, per aq kohe sa do te kete nje dalje te burimeve ekonomike dhe qe shuma mund te percaktohet me vertetesi. Ato maten me vleren e drejte te llogaritur me vleren neto te skontuar te pagesave te ardhshme ne daten e raportimit. Ne matjet e metejshme mjetet monetare te pagueshme rishikohen bazuar ne vleresimet ne daten e raportimeve me ndonje diference te njohur ne fitime ose humbje. Shuma e mbartur e detyrimit reflekton vleresimin e rishikuar te skontuar me normen origjinale te interesit efektiv.

Shpenzimet për shpërblimin e vjetërsisë në punë

Shpenzimet për shpërblimin e punonjësve të Shoqërisë në datën e mbylljes së konçesionit ne Korrik 2013, janë njohur si provizion duke patur parasysh që do të ketë një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike të Shoqërisë dhe të cilat mund të matën në mënyrë të besueshme. Duke qenë se data e pagesës së ketyre shpenzimeve është me e vogël se një vit, matja është bërë me kosto dhe nuk është skontuar.

(j) Njohja e te ardhurave

Te ardhurat nga Marreveshja e Konçesionit

Te ardhurat jane flukset bruto nga perfitimet ekonomike gjate periudhes qe vijne si rrjedhoje e aktiviteteve normale te njesise kur keto flukse rezultojne ne rritje te kapitalit te ndryshme nga rritjet te cilat vijne si rrjedhoje e kontributit nga aksioneret. Te ardhurat perfshijne vleren e drejte te pagesave te marra ose te arketueshme per shitjen e mallrave/sherbimeve gjate aktivitetit normal te Shoqerise. Te ardhurat paraqiten neto nga TVSH-ja, kthimet, uljet per nivele shitjesh, zbritjet dhe pasi eliminohen shitjet brenda Shoqerise, nese ka. Shoqeria i njeh te ardhurat kur vlera e tyre mund te matet ne menyre te besueshme, kur eshte e mundur qe Shoqeria do te kete perfitime te ardhshme ekonomike dhe kur permbushen kritere te caktuara. Vlera e te ardhurave nuk konsiderohet si e vleresuar me menyre te besueshme deri ne momentin kur te gjitha pasigurite ne lidhje me shitjen te jene zgjidhur. Te ardhurat e Shoqerise perbehen nga vlerat e marra per shitjet e kartave te identitetit dhe pasaportave me çmimin e caktuar dhe kontrolluar nga Autoriteti. Te ardhurat njihen kur kartat e identitetit apo pasaportat u vihen ne dispozicion qytetareve shqiptare. Pjesa e te ardhurave nga leternjoftimet dhe pasaportat e prodhuara por ende te padorezuara deri ne fund te vitit, shtyhet ne pasqyren e pozicionit financiar.

3. Permbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(k) Te ardhurat dhe kostot financiare

Te ardhura nga interesat njihen mbi baza kohore duke perdorur metoden e interesit efektiv. Kur nje kekese e arketueshme zhvleresohet, Shoqeria zvogelon vleren e mbetur te saj deri ne vleren e rikuperueshme, e cila eshte e barabarte me vleren e skontuar te flukseve monetare te ardhshme me normen e interesit efektiv te instrumentit, dhe vazhdon me njohjen e skontimit si te ardhura nga interesi. Kostoja Financave përfaqëson shpenzimet e interesit mbi huamarrjet. Kostot e huamarrjes që nuk lidhen drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar janë të njohura në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet në monedhë të huaj raportohen në baza neto ose si të ardhurave ose si shpenzim në varësi të faktit nëse lëvizjet në monedhë të huaj janë në një pozicion fitim neto ose humbje neto.

(l) Qirate

Qirate ne te cilat nje pjese e mire e rrezikut dhe shperblimeve mbahet nga qiradhenesi klasifikohen si qira operacionale. Pagesat e bera per qirate operacionale (netuar me te gjitha incentivat e marra nga qiradhenesi) njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve mbi baza lineare pergjate periudhes se kohezgjatjes se qirase.

(m) Tatim fitimi aktual dhe i shtyre

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale njihen në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose të ardhura të tjera përmbledhëse. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Ne percaktimin e vleres se tatimit fitimit aktual dhe te shtyre Shoqeria merr parasysh impaktin e pozicioneve tatimore te pasigurta dhe nese taksa dhe interesa shtese mund te jene te pagueshme. Shoqeria beson se perllogaritjet per detyrime tatimore jane te pershtatshme per te gjitha vitet bazuar ne vleresimin e shume faktoreve, duke perfshire interpretime te ligjit te taksave dhe eksperiences se meparshme. Ky vleresim mbeshtetet ne llogaritjet dhe supozimet dhe mund te perfshije nje sere gjykimesh rreth ngjarjeve te ardhshme. Informacion i ri mund te jete ne dispozicion dhe mund te shkaktoje qe Shoqeria te ndryshoje gjykimet ne lidhje me pershtatshmerine e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime te tilla ne detyrimet tatimore do te kene impakt tatim fitimin ne periudhat qe ky percaktim eshte bere.

Tatimi i shtyrë është njohur për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Tatimi i shtyrë është matur duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohet ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose që hyjnë në fuqi menjëherë në datën e raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjet fiskale të papërdorura, kreditime tatimore dhe diferenca të përkohshme të zbritshme për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato të mund të përdoren. Aktivi tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal. Aktivet dhe pasivet tatimore të shtyra netohen nëse ekziston një e drejtë ligjore për të netuar detyrimet për tatimin aktual të pagueshëm ndaj tatimit të parapaguar, dhe ato lidhen me tatimin mbi të ardhurat që përcakton i njëjti autoritet tatimor mbi të njëjtin subjekt tatimpagues.

(n) Standarde te reja dhe interpretime

Një numër standardesh të reja, ndryshimesh dhe interpretimesh nuk janë ende në fuqi për periudhen vjetore që përfundoi më 1 Janar 2012, dhe nuk janë zbatuar herët në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjë nga këto nuk pritet të ketë një efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare të kompanisë

4. Percaktimi i vleres se drejte

Një numër i politikave kontabël dhe deklarimeve të shoqerise kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet ne mjete financiare dhe jo-financiare. Vlerat e drejta janë përcaktuar për matjen dhe/ose qellime deklarimi bazuar në metodat vijuese. Kur është aplikuar, informacion të mëtejshëm mbi supozimet e bëra në përcaktimin e vlerave të drejta jane shprehur në shënimet specifike për aktivin ose detyrimin perkates.

Aktivet jo-materiale te koncesionit

Vlera e drejtë e aktiveve jo-materiale të marra si shpërblim për ofrimin e shërbimeve përkatëse në një marrëveshje koncesionare të shërbimit llogaritet duke ju referuar vlerës së drejtë të shërbimeve të ofruara dhe llogaritet si kosto totale.

Aktivet financiare te mbartura me kosto te amortizuar

Vlera e drejtë e kerkesave per t'u arkëtuar, duke perfshire sherbimet e arketueshme te koncesionit, llogaritet me aktuale të flukseve monetare të ardhshme, e zbritur sipas normën se interesit në datën e raportimit.

Detyrime financiare te mbartura me kosto te amortizuar t

Vlera e drejtë, e cila është përcaktuar për qëllime shënimi shpjegues, është llogaritur bazuar në vlerën aktuale të flukseve të ardhshme të principalit dhe interesit, skontuar me normën e tregut të interesit në datën e raportimit. Huate paraqiten me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv. Norma e interesit te aplikueshem eshte norma baze (e Bonove te Thesarit 12-mujore) e publikuar nga Banka e Shqiperise plus 1%, e ri-negociueshme çdo 12 muaj.

5. Menaxhimi i riskut financiar

Instrumentat financiare te shoqëria e ekspozojne ate ndaj reziqeve te meposhteme financiare:

-rreziku i tregut
-rreziku i kredise
-rreziku i likuiditetit

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të shoqerise në secilën prej rreziqeve të mësipërme, objektivat e shoqerise, politikat dhe proceset për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, si dhe menaxhimin e kapitalit. Shpalosje te mëtejshme sasiore janë të përfshira në të gjithë këto pasqyra financiare.Drejtuesit kane përgjegjësinë për themelimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut per shoqerine.

Kuadri i menaxhimit te riskut

Politikat per menaxhimin e rrezikut te shoqerise janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet shoqeria, për të vendosur kufijtë e duhura të rrezikut dhe kontrollit, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e kufinjve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut janë rishikuar rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktiviteteve të shoqerise. Shoqeria, me anë të trajnimeve të saj dhe standarteve te menaxhimit dhe procedurave, synon të zhvillojë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit të kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentet kryesore financiare të shoqerise përbëhen nga të holla në dorë dhe në banka, huazimet overdraft bankare, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, të shtyra dhe të tjera aktuale.

Risku i kredise

Rreziku i kredise eshte rreziku i humbjes financiare te shkaktuar nga deshtimi i pales tjeter per te shlyer detyrimet e saj financiare kundrejt Shoqerise dhe vjen kryesisht nga llogarite e arketueshme te Shoqerise.

Shoqeria nuk merr ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë, e cila është rreziku që një palë e një instrumenti financiar do të shkaktojë një humbje financiare për palën tjetër duke moskryer një detyrim.

Për shkak të përqendrimit të bazës së clienteles se shoqerise, përqendrimet errezikut të kredisë në lidhje me llogaritë e arkëtueshme janë të kufizuara. Zhvleresimi i llogarive te arketueshme percaktohet në shumën që konsiderohet e nevojshme për të mbuluar rreziqet potenciale në mbledhjen e balancave te llogarive të arkëtueshme.

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është përcaktuar si rrezik që një njësi ekonomike do të hasi vështirësi në përmbushjen e detyrimeve financiare. Shoqeria ekspozohet çdo dite ndaj levizjeve te burimeve monetare, kryesisht per te mbyllur shpenzimet operative gjate aktivitetit te saj te zakonshem. Drejtuesit monitorojne çdo dite, çdo jave dhe çdo muaj parashikimet e fluksit monetar te Shoqerise.

Luhatshmëria në tregjet financiare globale dhe Shqipëtare

Kriza globale financiare dhe ekonomike ka rezultuar, ndër të tjera, në një nivel më të ulët të financimit të kapitalit të tregut, nivelet me te ulëta të likuiditetit në të gjithë sektorin bankar dhe, disa here ne norma më të larta të kredidhënies ndërbankare dhe paqëndrueshmëri në tregjet e aksioneve. Pasiguritë në tregjet globale financiare kanë çuar edhe në dështimet dhe shpetimet e bankave ne të gjithë botën. Shtrirja e plotë endikimit të krizës financiare në vazhdim e bente pamunduar pamundur të parashikohen plotësisht masat mbrojtese.

Ndikimi mbi konsumatorët dhe huamarrësit

Qytetarët shqiptarë janë te vetmit klientë te Shoqerise që mund të preken negativisht nga kriza e vazhdueshme financiare dhe që mund të ndikojë në aftësinë e tyre për të paguar. Drejtuesit nuk jane në gjendje te përcaktoje efektet mbi pozicionin e ardhshëm financiar të shoqeisë apo ndonjë përkeqësim të mundshëm në mjedisin operative të shoqerise si rezultat i krizës në vazhdim. Drejtuesit besojn se është duke marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbështetur qëndrueshmërine dhe zhvillimin e biznesit të shoqerise në rrethanat aktuale. Drejtuesit besojn se ndikimi i krizës financiare globale mbi pozicionin financiar të kompanisë nuk do të jetë i rëndësishëm në vitin e ardhshëm.

Risku i tregut

Rreziku i tregut eshte rreziku i humbjes qe rezulton nga ndryshimet ne çmime, normat e kursit te kembimit, normat e interesit dhe cmimet kapitale. Niveli i rrezikut te tregut ndaj te cilit eshte ekspozuar Shoqeria varet nga kushtet e tregut, ligjet dhe rregulloret leshuar nga Autoriteti si dhe nga pritshmerite e kurseve te ardhshme apo levizjejve te normave te interesit. Drejtuesit kane vendosur limite per nivelin e rrezikut qe mund te pranohet, i cili monitorohet çdo muaj. Gjithsesi, perdorimi i kesaj metode nuk parandalon humbjet pertej ketyre limiteve ne rastin e ndodhjes se levizjeve me te rendesishme ne treg.

(i) Rreziku i kurseve te kembimit

Shoqeria operon me kurse kembimi dhe eshte e ekspozuar ndaj rrezikut te kurseve te kembimit qe vijne nga ekspozimi ndaj valutave, ne vecanti ne lidhje me Euro dhe USD. Rreziku i kurseve te kembimit rritet kur transaksionet financiare apo njohja e aktiveve dhe detyrimeve behet ne nje monedhe e cila nuk eshte monedha funksionale e Shoqerise. Ne lidhje me rrezikun e kurseve, Drejtuesit kane caktuar limite mbi nivelin e ekspozimit per çdo valute dhe ne total. Pozicioni monitorohet çdo muaj. Shoqeria nuk mbrohet ndaj rrezikut te kurseve te kembimit pasi nuk pret humbje te medha qe mund te ndodhin si pasoje e luhatjeve ne normat e valutave te krahasuara me kursin e perdorur ne daten e raportimit.

(ii) Rreziku i çmimit

Shoqeria nuk ka asnje ekspozim ndaj rrezikut te çmimit te kapitalit perderisa ajo nuk mban aktive financiare qe permbajne instrumenta kapitali ne daten e raportimit. Nuk eshte ne politiken e Shoqerise te bleje instrumenta te tilla dhe ne kete menyre te ekspozoje veten ndaj rrezikut te cmimit lidhur me levizjet ne tregun e kapitaleve. Marreveshja e Konçesionit percakton nje cmim fiks per kartat e identitetit dhe pasaportat. Rreziku i cmimit ne lidhje me Marreveshjen e Konçesionit eshte vleresuar i ulet.

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i tregut

(iii) Rreziku i normes se interesit

Aktivet e Shoqerise mbi te cilat aplikohet interes konsistojne ne llogari rrjedhese ne banka, keshtu qe te adhurat e Shoqerise dhe flukset monetare operative jane te pavarura nga ndryshimet ne tregun e normave te interesit.

Shoqeria ka detyrime mbi te cilat aplikohet interes vetëm në 31 dhjetor 2011

Manaxhimi i kapitalit

Shoqeria eshte krijuar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar vetem per qellimin e implementimit te Marreveshjes se Konçesionit. Bazuar ne legjislacionin shqiptar, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar kerkohet te kete kontribute ne kapital nga aksioneret por nuk ka si detyrim krijimin e rezervave ligjore. Kapitali aksionar eshte kontribuar nga ortaket pjeserisht ne natyre por gjithashtu dhe ne para. Kapitali neto perbehet vetem nga 'Kapitali i regjistruar', i paguar dhe i papaguar, dhe nga 'Fitimet e akumuluara'. Kapitali minimal i kerkuar per shoqerite me pergjegjesi te kufizuara eshte 100,000 Lek.

6. Aktive jo-materiale

	Permiresime te ndertesave ne perdorim	Makineri dhe pajisje Machinery	Liçenca per software	Permiresime te zyrave me qera	Moblije dhe pajisje te tjera	Kompjutera dhe pajisje zyrash	Automjete	Te tjera	Totali
Kosto									
Gjendja me 1 janar 2011	183,295,248	220,584,655	2,124,799,615	525,592	37,143,119	330,221,761	13,571,628	53,811,016	**2,963,952,634**
Shtesa	5,000,000	-	-	-	1,439,924	28,878,023	-	-	**35,317,947**
Pakesime	-	-	-	-	-	(6,673,333)	-	-	**(6,673,333)**
Gjendja me 31 dhjetor 2011	**188,295,248**	**220,584,655**	**2,124,799,615**	**525,592**	**38,583,043**	**352,426,451**	**13,571,628**	**53,811,016**	**2,992,597,248**
Shtesa	6,966,035	-	-	-	34,883	33,957	-	-	**7,034,875**
Pakesime	-	-	-	-	(272,476)	(355,552)	-	-	**(628,028)**
Gjendja me 31 dhjetor 2012	**195,261,283**	**220,584,655**	**2,124,799,615**	**525,592**	**38,345,450**	**352,104,856**	**13,571,628**	**53,811,016**	**2,999,004,095**
Amortizimi i akumuluar									
Gjendja me 1 janar 201	(73,998,989)	(91,725,261)	(808,630,625)	(525,592)	(14,045,424)	(130,004,502)	(4,310,919)	(18,569,130)	**(1,141,810,442)**
Amortizimi i vitit	(42,308,229)	(49,881,055)	(509,484,770)	-	(9,138,450)	(81,769,063)	(3,584,791)	(13,642,020)	**(709,808,378)**
Pakesime	-	-	-	-	-	770,000	-	-	**770,000**
Gjendja me 31 dhjetor 2011	**(116,307,218)**	**(141,606,316)**	**(1,318,115,395)**	**(525,592)**	**(23,183,874)**	**(211,003,565)**	**(7,895,710)**	**(32,211,150)**	**(1,850,848,820)**
Amortizimi i vitit	(45,466,125)	(49,881,055)	(509,484,770)	-	(9,688,710)	(89,309,532)	(3,584,791)	(13,642,020)	**(721,057,003)**
Pakesime	-	-	-	-	191,742	284,442	-	-	**476,184**
Gjendja me 31 dhjetor 2012	**(161,773,343)**	**(191,487,371)**	**(1,827,600,165)**	**(525,592)**	**(32,680,842)**	**(300,028,655)**	**(11,480,501)**	**(45,853,170)**	**(2,571,429,639)**
Vlera e mbetur									
Me 1 janar 2011	109,296,259	128,859,394	1,316,168,990	-	23,097,695	200,217,259	9,260,709	35,241,886	**1,822,142,192**
Me 31 dhjetor 2011	71,988,030	78,978,339	806,684,220	-	15,399,169	141,422,886	5,675,918	21,599,866	**1,141,748,428**
Me 31 dhjetor 2012	**33,487,940**	**29,097,284**	**297,199,450**	**-**	**5,664,608**	**52,076,201**	**2,091,127**	**7,957,846**	**427,574,456**

7. Inventaret

Inventare me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 perbehen si me poshte:

	2012	2011
Lende te para:		
Pasaporta	351,427,064	258,003,847
Karta identiteti	64,771,575	83,112,230
Fatura per Kartat identiteti dhe Pasaporta	3,554,186	4,690,841
Totali	**419,752,825**	**345,806,918**

8. Kerkesa per t'u arketuar

Kërkesat per t'u arketuar me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 perbehen si me poshte:

	2012	2011
Te arketueshme nga klientet	117,065,526	141,417,036
Zbritje: zhvleresim te kerkesave per t'u arketuar	(21,029,250)	(20,626,260)
Totali	**96,036,276**	**120,790,776**

Kerkesat per t'u arketuar perbehen si meposhte:

	2012	2011
Posta Shqiptare	79,789,930	98,739,081
Ministria e Puneve te Jashtme	23,290,026	29,095,376
Institucione shteterore shqiptare	7,372,170	6,969,179
Morpho	6,613,400	6,613,400
Totali	**117,065,526**	**141,417,036**

Kerkesat e arketueshme nga Posta Shqiptare dhe Institucione shteterore shqiptare lidhen me shitjen e kuponave per karta identiteti dhe pasaporta. Kerkesa per t'u arketuar nga aksioneri, Morpho, lidhet me shitje makinerie dhe eshte plotesisht e zhvleresuar.

Shuma per tu arketua, individualisht e rendesishme, prej 13,675,081 Lek nga institucionet shteterore te cilat konsiderohen plotësisht te zhvlerësuara duke qene se jane vonuar per me shume se nje vit. Nje zhvlerësim i tille eshte regjistruar per kërkesat e arketueshme te Postes Shqiptare ne vleren 7,043,680 Lek dhe institucioneve te tjera shteterore ne vleren 7,372,171 Lek. Levizjet ne zhvleresim te kerkesave per t'u arketura gjate 2012 dhe 2011 jane si me poshte:

	2012	2011
Gjendja me 1 janar	20,626,260	13,657,081
Shtesat e vitit	402,990	6,969,179
Gjendja me 31 dhjetor	**21,029,250**	**20,626,260**

9. Parapagime dhe te tjera per t'u arketuar

Parapagime dhe te tjera per tu arketuar me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 perbehen si me poshte:

	2012	2011
Parapagime per sherbime mirembajtjeje	15,881,006	16,330,758
Interesa per t'u arketuar	1,763,051	657,818
Parapagime per tarifen e MPJ-se	646,996	797,524
Parapagime per personelin	10,000	124,579
Paragime te tjera	576,970	377,460
Totali	**18,878,023**	**18,288,139**

10. Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente

Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 perbehen si me poshte:

	2012	2011
Arka:		
Ne EUR	729,922	524,145
Ne USD	387,209	-
Ne LEK	562,546	460,678
	1,679,677	**984,823**
Banka:		
Llogari rrjedhese		
Ne EUR	69,462,434	35,167,577
Ne USD	3,203,378	-
Ne LEK	26,084,567	41,199,565
Depozita me afat		
Ne EUR	628,155,000	25,674,788
Ne LEK	200,000,000	648,713,091
	926,905,379	**750,755,021**
Totali	**928,585,056**	**751,739,844**

11. Kapitali

Me poshte eshte përmbledhja e kuotave te kapitalit ne përfundim te secilit vit:

	31 dhjetor 2012 dhe 2011		
	Numri i kuotave	Pronësia %	Lek
Morpho	1.00	75.00	464,812,500
FSHAN	1.00	25.00	154,937,500
	2.00	**100.00**	**619,750,000**

Asamblea e Aksionerëve, në 27 mars 2012, ka miratuar shpërndarjen e fitimit neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011 si vijon:

Fitimi neto per 2011	1,102,862,785
Dividend te paguar ne 2012	1,050,000,000

Nderkohë, gjatë vitit 2011 një divident perj Lek 1,365,000 mije eshte shperdare.

12. Provizione

Provizionet me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 jane si me poshtë:

	2012	2011
Provizioni për shërbimin e mirëmbajtjes *(i)*	47,299,720	47,299,720
Provizioni për shpërblimin e vjetërsisë në pune *(ii)*	20,000,000	-
Total	**67,299,720**	**47,299,720**

(i) Provizioni për shërbimin e mirëmbajtjes

Shuma prej 47,299,720 Lek ekuivalente ne 340,000 Euro, konsiston ne provizione per sherbime mirembajtjeje qe Shoqeria, sipas Marreveshjes se Konçesionit, ka per detyre te kryeje ne lidhje me sistemin e pajisjeve dhe softwaret e aplikimit qe do t'i dorezohen Autoritetit per nje periudhe prej nje vit pas mbarimit te Kontrates, pa pagesa shtese**.** Rakordimi i provizioneve me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 si me poshte:

	2012	2011
Gjendja me 1 janar	47,299,720	37,467,900
Diferenca kembimi	-	9,831,820
Gjendja me 31 dhjetor	**47,299,720**	**47,299,720**

(ii) Provizioni për shërbimin e mirëmbajtjes

Shhuma prej 20,000,000 Lek, konsiston ne provizione per që Shoqëria i detyrohet punonjësve te saj në fund të periudhës së konçensionit ne korrik 2013. Ne baze te Marrëveshjes së Konçensionit, Autoriteti nuk është i detyruar që të mbajë në punë punonjësit e Shoqërisë mbas dates se dorezimit. Si pasoje Shoqeria ka njohur nje provision bazuar ne përcaktimet e Kodit të Punëse së Republikës së Shqipërisë, i cili këkon qe të shpërblehen punonjesit ne baze te vjetersise qe do kene ne momentin e dorezimit te veprimatirisë. Ne 31 dhjetor 2011 nuk ka patur informacion te mjaftueshem për te vlerësuar këtë provision.

13. Hua dhe kredi

Me 31 dhjetor 2012 dhe 2011, shumat e mbartura dhe vlerat e drejta per huate afatshkurtra dhe afatgjata jane si me poshte:

	2012	2011
Afatshkurter		
Hua nga Banka Societe General	-	58,488,690
Interesi i përllogaritur	-	434,950
	-	**58,923,640**
Total	**-**	**58,923,640**

Principali i huase
Bazuar ne marreveshjen e huase nenshkruar me 30 qershor 2009 me banken Societe Generale Albania(ish Banka Popullore), Shoqeria mori nje hua ne shumen 1,713,800,000. Huaja, duke perfshire interesin dhe principalin, do te paguhet brenda 30 muajve duke nisur nga data e disbursimit te pare qe eshte 2 korrik 2009.

Interesi i huase
Ne perputhje me marreveshjen e huase, norma e interesit te huase eshte norma baze e publikuar nga Banka e Shqiperise (bono thesari 12 mujore) plus 1% dhe detyrimi per interesa llogaritet mbi shumen e mbetur te huase se disbursuar. Interesi eshte i pagueshem çdo muaj dhe norma e interesit rishikohet çdo 12 muaj.

Garanci

Morpho ka leshuar nje garanci te perbashket ne favor te bankes Societe Generale per plotesimin e gjithe kushteve te marrëveshjes se huase dhe pagimin e gjithe detyrimeve te shoqerise.

14. Detyrime per t'u paguar

Detyrimet per t'u paguar me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 perbehen si me poshte:

	2012	2011
Furnitore	74,580,569	48,674,521
Shpenzime te perllogaritura	5,405,322	8,840,646
Totali	**79,985,891**	**57,515,167**

Furnitoret perbehen si me poshte:

	2012	2011
Morpho	70,467,709	39,447,669
Other	4,112,860	9,226,852
Totali	**74,580,569**	**48,674,521**

15. Te tjera detyrime

Te tjera detyrime me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 perbehen si meposhte:

	2012	2011
TVSH e pagueshme	23,934,611	43,846,173
Tatime te lidhura me pagat	6,092,416	6,859,631
Paga te pagueshme	499,835	-
Detyrime tatimore te tjera	4,889	-
Totali	**30,531,751**	**50,705,804**

16. Te ardhura te shtyra

Te ardhurat e shtyra me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 perbehen si meposhte:

	2012	2011
Te ardhura te shtyra per shitjen e kartave te identitetit	51,169,200	57,231,600
Te ardhura te shtyra per shitjen e pasaportave	85,460,000	91,680,000
Te ardhura te shtyra per sherbime shtese Autoritetit	10,675,090	10,675,090
Te ardhura te shtyra per shitjen e pasaportave me procedure te pershpejtuar	5,700,000	20,550,000
Te ardhura te shtyra per shitjen e kartave te identitetit ne Ambasada	1,699,407	1,602,038
Te ardhura te shtyra per shitjen e pasaportave ne Ambasada	8,559,316	14,213,506
Te ardhura te shtyra per shitjen e kartave te identitetit ne Ambasada US	157,429	-
Te ardhura te shtyra per shitjen e pasaportave ne Ambasada US	1,659,216	-
Totali	**165,079,658**	**195,952,234**

Te ardhurat e shtyra me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 perbehen nga te ardhurat te realizuara nga shitja e kuponave per karta identiteti dhe pasaporta tek qytetaret shqiptare, institucione te tjera shteterore si dhe Ministria e Puneve te Jashtme, te cilat nuk jane prodhuar ende. Keto te ardhura do te njihen ne momentin qe kartat e identitetit dhe pasaportat do t'u vihen ne dispozicion klienteve per terheqje.

Te ardhurat e shtyra me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 nga sherbime shtese per Autoritetet perbehen kompesime per tu marre nga Autoriteti per prodhimin e dokumentave te refugjateve ne vitin pasardhes.

17. Tarifa konçesioni

Detyrimi i perllogaritur per tarifa konçesioni ne nje shume prej Lek 152,808,221 (2011: 258,319,029 Lek) ka te beje me tarifen e konçesionit qe Shoqeria eshte e detyruar t'i paguaje Autoritetit ne nje mase prej 5% te xhiros totale vjetore nga shitja e kartave te identitetit (TVSH e perjashtuar) bazuar ne kushtet e Marreveshjes se Konçesionit. Sipas specifikimeve te Amendimit, detyrimi i perllogaritur per tarifen e koncesionit, paguhet ne vitin pasardhes per aq kohe sa palet nuk kane rene dakort ndryshe; sipas detajimit me poshte:

	2012	2011
Gjendja ne fillim	258,319,029	49,334,271
Tarifa e konçesionit 5% e qarkullimit vjetor	152,808,221	258,319,029
Tarifa konçesioni paguar Autoritetit	-	(49,334,271)
Gjendja ne fund	**411,127,250**	**258,319,029**

Pagesa e tarifes se koncesionit per vitin 2011 eshte shtyre ne vitin 2013 sipas kërkese se Autoritetit

18. Shitjet

Shitjet me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 perbehen si meposhte:

	2012	2011
Pasaportat	1,144,430,000	3,299,820,000
Kartat e identitetit	230,588,400	485,295,600
Kartat e identitetit shitur nga ambasadat	49,590,799	32,623,007
Pasaportat e shitura nga amabasadat	740,939,509	460,820,625
Pasaportat me procedure te pershpejtuar	931,762,500	913,425,000
Totali	**3,097,311,208**	**5,191,984,232**

19. Te ardhura te tjera

Te ardhura te tjera me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 perbehen si meposhte:

	2012	2011
Te ardhura nga sherbime shtese per Autoritetin	-	74,322,200
Fitimi neto nga shitja e aktiveve	252,184	703,117
Shitje te tjera	-	875,226
Totali	**252,184**	**75,900,543**

Te ardhurat nga sherbimet shtese per Autoritetin jane te perbera si me poshte:

	2012	2011
Kompesim nga Autoriteti per rritjen e kapacitetit te prodhimit te pasaportave	-	74,322,200
Totali	**-**	**74,322,200**

20. Lendet e para

Lendet e para me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 perbehen si meposhte:

	2012	2011
Kostoja e pasaportave te shitura	834,112,248	1,891,242,944
Kostoja e kartave te identitetit te shitura	191,363,586	369,661,835
Materiale ambalazhimi	6,311	-
Totali	**1,025,482,145**	**2,260,904,779**

21. Shpenzime personeli

	2012	2011
Paga	220,218,331	264,525,407
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	24,693,201	32,186,690
Totali	**244,911,532**	**296,712,097**

22. Furnizime dhe shërbime

Furnizime dhe shërbime me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 perbehen si meposhte:

	2012	2011
Sherbime mirembajtjeje	195,321,907	197,321,187
Asistence teknike	89,175,751	108,692,525
Komisione dhe shpenzime shitjeje per pasaportat	44,884,303	33,002,043
Shpenzime telekomunikacioni dhe postare	28,668,476	41,230,612
Shpenzime udhetimi	11,667,237	8,402,072
Sherbime komunale	5,794,747	5,857,258
Sherbime konsulence	5,705,061	8,091,625
Komisione dhe shpenzime shitjeje per kartat e identitetit	4,567,848	9,648,161
Shpenzime transporti dhe karburanti	3,778,893	4,993,971
Humbje teknike ne prodhim	3,775,302	9,899,687
Qira makinash	3,447,674	7,037,830
Kancelari dhe materiale	3,113,744	6,295,472
Shpenzime perfaqesimi	1,611,236	1,134,932
Sigurime	847,816	2,650,459
Shpenzime trajnimi personeli dhe te tjera	843,055	227,011
Shpenzime te ndryshme	8,791,501	20,043,800
Totali	**411,994,551**	**464,528,645**

23. Shpenzime financiare neto

Shpenzime financiare neto per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 perbehet si me poshte:

	2012	2011
Te ardhura financiare:		
Te ardhura nga interesi mbi depozitat	23,778,192	16,757,521
Fitimet neto nga kursi i kembimit	15,032,908	17,170,232
	38,811,100	**33,927,753**
Shpenzime financiare:		
Shpenzime interesi	-	(37,718,754)
Shpenzime per garanci bankare	(1,480,178)	(1,937,623)
Humbje nga kursi i kembimit	(7,787,857)	(27,275,236)
Komisione bankare	(436,683)	(409,275)
	(9,704,718)	**(67,340,888)**
Totali	**29,106,382**	**(33,413,135)**

24. Tatim-fitimi

Tatim-fitimi i njohur ne fitim dhe humbje per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 perbehet si meposhte:

	2012	2011
Shpenzime tatim-fitimi	64,457,894	138,024,462
Te ardhura (shpenzime) nga tatimet e shtyra	25,511,220	(13,489,533)
Totali	**89,969,114**	**124,534,929**

Rakordimi i normes efektive te tatim fitimit:

	2012	%	2011	%
Fitimi per vitin	460,044,218		1,102,862,785	
Totali i tatim fitimit	89,969,114		124,534,929	
Fitimi pas tatim-fitimit	550,013,332		1,227,397,714	
Tatim fitimi me normen e aplikueshme	55,001,333	10.00	122,773,977	10.00
Shpenzime te panjohura	1,917,783	0.30	3,772,177	0.30
Ndryshimi ne diferencat e perkohshme te panjohura	7,538,778	1.40	-	-
Nen/(mbi) llogaritje per periudhat e mëparshme	25,511,220	4.60	(2,011,225)	(0.20)
Totali	**89,969,114**	**16.30**	**124,534,929**	**10.10**

Detyrimi per tatim fitim e periudhes prej Lek 3,591,745 (2011: Lek 12,003,328) perfaqeson shumen e mbetur te tatim fitimit te pagueshem te periudhes me 31 dhjetor 2012.

Parapagimet per tatimin e fitimit gjate 2012 dhe 2011 janë vlerësuar nga ana e autoriteteve tatimore në bazë të fitimit të vitit të kaluar, si të përcaktuara nga ligjet dhe rregulla tatimore shqiptare

Aktivet dhe pasivet tatimore të shtyra te njohura atribuohen si meposhte:

	Aktive		Pasivet		Neto	
	2012	2011	2012	2011	2012	2011
Aktive jo-materiale	-	18,173,180	-	2,159,986	-	16,013,194
Kosto fillestare	-	1,050,502	-	-	-	1,050,502
Kerkesa per t'u arketuar	-	3,133,487	-	-	-	3,133,487
Detyrime per t'u paguar	-	5,314,037	-	-	-	5,314,037
	-	**27,671,206**	-	**2,159,986**	-	**25,511,220**

Aktivet dhe pasivet tatimore të shtyra te panjohura atribuohen si meposhte:

	Aktive		Pasivet		Neto	
	2012	2011	2012	2011	2012	2011
Aktive jo-materiale	23,525,297	-	795,784	-	22,729,513	-
Kosto fillestare	735,352	-	-	-	735,352	-
Kerkesa per t'u arketuar	2,314,629	-	-	-	2,314,629	-
Detyrime per t'u paguar	7,270,504	-	-	-	7,270,504	-
	33,845,782	-	**795,784**	-	**33,049,998**	-

24. Tatim-fitimi (vazhdim)

Shoqeria nuk parashikon te realizoje fitim te mjaftueshem gjate periudhes shtate mujore deri ne dorezim te Koncesionit me 25 korrik 2013 i cili te lejoje zbritjet e diferencave të perkokohshme te cilat rrjedhimisht do rezultonin ne nje aktiv tatimor te shyre ne daten e raportimit. Si rrjedhoje me 31 dhjetor 2012 nuk jane njohur aktive per tatim fitimin e shyre.

25. Angazhime, garanci dhe detyrime te kushtezuara

Gjate aktivitetit normal te biznesit, Shoqeria mund te perfshihet ne pretendime te ndryshme nga te trete dhe nga masa ligjore. Sipas opinionit te drejtuesve, rezultatet e ketyre çeshtjeve nuk do kene efekt material ne pasqyrat financiare te Shoqerise apo ndryshime ne aktivet neto, perveç atyre per te cilat eshte llogaritur nje provizion ne keto pasqyra financiare.

Angazhimet kapitale

Shoqeria nuk ka angazhime kapitale te kontraktuara por ende te pazbatuara me 31 dhjetor 2012 dhe 2011.

Angazhimet per qira operacionale

Shoqeria nuk rezulton te kete asnje marreveshje te pa-anullueshme per qira operacionale me 31 dhjetor 2012 dhe 2011.

Garancite

Ne perputhje me kushtet e Marreveshjes se Konçesionit, Shoqeria ka vene ne dispozicion te Autoritet nje garanci ne formen e nje Obligacioni te Performances ne shumen 10 milion Euro, e cila do te jete e vlefshme pergjate marreveshjes, por do te reduktohet si me poshte:

a) 3 milion Euro brenda 30 diteve nga leshimi i kartes se pare te identitetit
b) 3 milion Euro brenda 30 diteve nga pervjetori i pare i Dates Efektive
c) 1 milion Euro brenda 30 diteve nga pervjetori i dyte i Dates Efektive
d) 0.5 milion Euro brenda 30 diteve nga pervjetori i trete i Dates Efektive
a) 2.5 milion Euro ne fund te Periudhes se Konçesionit

Sipas Marreveshjes se Konçesionit, ne rastet kur Konçesionari nuk paguan detyrimet e percaktuara ne Marreveshje, Autoriteti duke u bazuar ne te drejtat e tij mund te perfitoje çdo shume nga Obligacioni i Performances, dhe Konçesionari eshte i detyruar t'ia paguaje Autoritetit shumen e kerkuar.Garancia eshte zvogeluar ne cdo vit duke qene se marrëveshja ka skaduar pa ndonje pretendim ndaj Shoqerise. Ne 31 dhjetor 2012, garancia u pakesua ne 2.5 milion Euro pa ndonje pretendim ndaj Shoqerise.

26. Transaksionet me palet e lidhura

Ne daten e raportimit jane kryer transaksionet e meposhtme me palet e lidhura te cilat jane Morpho dhe FSHAN, aksioneret e Shoqerise:

	2012	2011
Kerkesa te arketueshme:		
Morpho	7,372,170	6,969,179
Detyrime per t'u paguar:		
Morpho	70,467,709	39,447,669

Gjate vitit shoqeria ka kryer transaksionet e mëposhtme me palet e lidhura:

	2012	2011
Te ardhura (shitja e aktiveve):		
Morpho	404,028	6,606,450
Shpenzime:		
FSHAN	45,773,092	45,833,455
Morpho	1,345,063,380	2,408,269,693
Zhvleresim per arketim		
Morpho	402,990	6,969,179
	1,391,239,462	**2,461,072,327**
Blerje e aktiveve:		
Morpho	-	28,636,626
Totali i transaksioneve	**1,390,835,434**	**2,483,102,503**

Sic eshte shpjeguar ne Shenimin 13 Morpho ka dhene garanci per Societe General Albania per huat e marra nga Shoqëria.

Kompensimi per personelin drejtues kryesor

Me 31 dhjetor 2012 dhe 2011, Shoqeria kishte strukturen e meposhtme te drejtimit:
Drejtor Ekzekutiv
Drejtor Operacional
Drejtori i Finances
Drejtori i Cilesise
Drejtori i Teknologjise se Informacionit
Drejtori i Prodhimit
Drejtori i Rekrutimeve
Drejtori i Sigurise
Drejtori i Burimeve Njerezore

Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2012 kompenisimi per personelin drejtues ishte Lek 53,911,737 (2011: Lek 52,968,165).

27. Instrumenta financiar

Risku i kredise

Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë. Reziku maksimal ndaj riskut të kredisë në datën e raportimit ishte:

	Dhjetor 31,	
	2012	**2011**
Kerkesa per t'u arketuar	96,036,276	120,790,776
Interes per t'u arketuar	1,763,051	657,818
Mjete monetare dhe ekuivalente	928,585,056	751,739,844
	1,026,384,383	873,188,438

Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë për llogari të arkëtueshme në datën e raportimit sipas llojit të rajonit gjeografik ishte:

	Dhjetor 31,	
	2012	**2011**
Vendas	96,036,276	120,790,776
I huaj	-	-
	96,036,276	120,790,776

Humbejt nga zhvleresimet

Vjetersia e kerkesave te arketueshme ne daten e raportimit ishte:

	Bruto	Zhvleresim	Bruto	Zhvleresim
	2012	**2012**	**2011**	**2011**
Më pak se një vit	96,036,276	-	120,790,776	-
Më shumë se një vit	21,029,250	(21,029,250)	20,626,260	(20,626,260)
Gjendja në fund te vitit	**117,065,526**	**(21,029,250)**	**141,417,036**	**(20,626,260)**

27. Instrumenta financiar (vazhdim)

Risku i likuiditetit

Më poshtë janë maturimet kontraktuale të aktiveve dhe detyrimeve financiare, duke përfshirë pagesat e interesit me 31 dhjetor 2012 dhe 2011:

31 dhjetor 2012	Vlera e kontabel	Me pak se 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	Mbi 1 vit
Aktive financiare					
Kërkesa per t'u arketuar	**96,036,276**	96,036,276	-	-	-
Parapagime dhe te tjera per t'u arketuar	**1,763,051**	1,763,051	-	-	-
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente	**928,585,056**	928,585,056	-	-	-
	1,026,384,383	1,026,384,383	-	-	-
Detyrime financiare					
Detyrime per t'u paguar	**(79,985,891)**	(79,985,891)	-	-	-
Te tjera detyrime	**(30,531,751)**	(30,531,751)	-	-	-
Tarife konçesioni	**(411,127,250)**	(258,319,029)	(152,808,221)	-	-
Hua dhe kredi	**-**	-		-	-
	(521,644,892)	(368,836,671)	(152,808,221)	-	-
Ekspozimi neto me 31 dhjetor 2012	**504,739,491**	**657,547,712**	**(152,808,221)**	**-**	**-**

31 dhjetor 2011	Vlera e kontabel	Me pak se 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	Mbi 1 vit
Aktive financiare					
Kërkesa per t'u arketuar	**120,790,776**	120,790,776	-	-	-
Parapagime dhe te tjera per t'u arketuar	**657,818**	657,818	-	-	-
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente	**751,739,844**	751,739,844	-	-	-
	873,188,438	873,188,438	-	-	-
Detyrime financiare					
Detyrime per t'u paguar	**(57,515,167)**	(57,515,167)	-	-	-
Te tjera detyrime	**(50,705,804)**	(50,705,804)	-	-	-
Tarife konçesioni	**(258,319,029)**	-	(258,319,029)	-	-
Hua dhe kredi	**(58,923,640)**	(58,923,640)	-	-	-
	(425,463,640)	**(167,144,611)**	**(258,319,029)**	-	-
Ekspozimi neto me 31 dhjetor 2011	**447,724,798**	**706,043,827**	**(258,319,029)**	**-**	**-**

27. Instrumenta financiar (vazhdim)

Risku i tregut
Risku i kurseve te kembimit

Reziku i kurseve te kembimit per Shoqerine me 31 dhjetor 2012 dhe 2011 ishte si me poshte:

31 dhjetor 2012	**Vlera kontable**	**EUR**	**USD**	**Lek**
Kerkesa per t'u arketuar	**96,036,276**	22,233,643	1,056,383	72,746,250
Parapagime dhe aktive te tjere	**1,763,051**	1,437,914	-	325,137
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente	**928,585,056**	698,347,355	3,590,589	226,647,112
Detyrime per t'u paguar	**(79,985,891)**	(74,126,962)	-	(5,858,929)
Te tjera detyrime	**(30,531,751)**	-	-	(30,531,751)
Tarife konçesioni	**(411,127,250)**	-	-	(411,127,250)
Ekspozimi neto	**504,739,491**	**647,891,950**	**4,646,972**	**(147,799,431)**

31 dhjetor 2011	**Vlera kontable**	**EUR**	**USD**	**Lek**
Kerkesa per t'u arketuar	**120,790,776**	29,095,376	-	91,695,400
Parapagime dhe aktive te tjere	**657,818**	657,818	-	-
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente	**751,739,844**	684,404,814	-	67,335,030
Detyrime per t'u paguar	**(57,515,166)**	(44,096,334)	-	(13,418,832)
Te tjera detyrime	**(50,705,804)**	-	-	(50,705,804)
Tarife konçesioni	**(258,319,029)**	-	-	(258,319,029)
Hua dhe kredi	**(58,923,640)**	-	-	(58,923,640)
Ekspozimi neto	**447,724,799**	**670,061,674**	-	**(222,336,875)**

Meposht paraqiten kurset e kembimit gjate vitit:

Lek	**Kursi mesatar**		**Kursi ne daten e kembimit**	
	2012	**2011**	**2012**	**2011**
EUR 1	139.01	140.35	139.59	138.93
USD 1	108.19	100.95	105.85	107.54

Analiza e ndjeshmerise

Një forcimi ose dobësimi i lekut, kundrejt euros më 31 dhjetor do të kishte ulur përkatësisht ose rritur kapitalin dhe fitimin ose humbjen nga shumat e treguara më poshtë. Kjo analizë është e bazuar ne 5% variance ne kursin e kembimit, qe shoqeria e parashikon të ndodh në fund të periudhës raportuese.Analiza është kryer mbi të njëjtën bazë për vitin 2011.

Lek	**31 dhejtor 2012**		**31 dhjetor 2011**	
	Kapital	**Fitimi ose humbje**	**Kapital**	**Fitim ose humbje**
EUR	32,394,598	32,394,598	33,503,084	33,503,084

27. Instrumenta financiare (vazhdim)

Risku i normes se interesit
Profil

Në datën e raportimit, profili i Shoqerise per instrumentete financiare me interes ishte:

	31 dhjetor	
	2012	**2011**
Intrumentet me norme fikse		
Aktive financiare	847,663,958	674,387,879
Instrumentet me norme te ndryshushme		
Detyrime financiare	-	58,923,640

Analiza e ndjeshmërisë së vlerës së drejtë për instrumentet me normë fikse

Shoqëria nuk bën regjistrime në fitim ose humbje për ndonjë aktiv apo detyrim financiar me normë fikse në vlerën e drejtë. Kështu që një ndryshim me 50 pike në normat e interesit do të rriste ose zvogëlonte kapitalin me Lek 42,383,198 (2011: Lek 33,719,394)

Analiza e ndjeshmërisë së mjeteve monetare për instrumentet me norma variabël

Aktivet e Shoqerise mbi te cilat llogaritet interes jane llogari rrjedhese dhe depozita, si pasoje, te ardhurat dhe flukset monetare te Shoqerise jane substacialisht te pavarura nga ndryshimet ne normat e interesit ne treg. Shoqeria ka shlyer detyrime mbi te cilat aplikohet interes, ne daten 3 janar 2012. Si e tille, duke marre parasysh se data e shlyerjes eshte ne nje dite pune nga data e bilancit shpenzimet e Shoqerise dhe flukset monetare operative nuk kane gjasa te ndikohen nga levizjet e normave te interesit ne treg dhe me specifikisht nga normat e bonove te thesarit 12 mujore te publikuara nga Banka e Shqiperise.

Shoqeria nuk ka ndonje detyrim mbi te cilat aplikohet interes ne 31 dhjetor 2012

28. Ngjarje pasuese

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit financiar e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.